



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-016/01-63314, e datës 26.12.2024, Kryetari i Komunës nxjerr,

**VENDIM MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE NË QYTETIN E
LIPJANIT**

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt- Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në qytetin e Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt- Rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në qytetin e Lipjanit, mund t'ia dërgoni Komisionit për hartimin e Projekt- Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në qytetin e Lipjanit ose në email adresën sead.aliu@rks-gov.net, më së largu me datë 17.06.2026.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 343/01-24634
Lipjan, më 02.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

